

**VENDIM**  
**Nr. 650, datë 13.8.2020**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË  
BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E HARTIMIT TË PROJEKTIT TË  
NDËRHYRJEVE REHABILITUESE/PËRSHTATËSE, TË NEVOJSHME PËR  
KTHIMIN E STRUKTURËS SË OBJEKTEVE QË JANË KLASIFIKUAR SI  
OBJEKTE ME DËMTIME TË MËDHA STRUKTURORE OSE DËMTIME SHUMË  
TË RËNDA JOSTRUKTURORE, NË BASHKITË TIRANË DHE KURBIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, në masën 144 289 030 (njëqind e dyzet e katër milionë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tridhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore (me shkallë dëmtueshmërie DS4 dhe DS5), në bashkitë Tiranë dhe Kurbin.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2020, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 87 358 750 (tetëdhjetë e shtatë milionë e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore (DS4 dhe DS5).

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi prej 56 930 280 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore (DS4 dhe DS5).

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Tiranë dhe Kurbin, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**